



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
BASHKIA HIMARË  
DREJTORIA E ZHVILLIMIT EKONOMIK

Nr. 3939 prot.

Himarë, më 26.05.2025

**Lënda:** Shkresë përcjellëse mbi relacionin e realizimin të treguesve ekonomik për katër mujin e parë të 2025

**KESHILLIT BASHKIAK HIMARË**

**KËTU**

Bazuar në Ligjin Nr. 139/2015, datë 17.12.2015 "Për Vetëqeverisjen Vendore", neni 8, neni 9/1 pika 1/1 a dhe b, pika 1/3 c, nenet 10, 24, 40/4, 54/k; Mbështetur në nenet 34,40,41,45,55 të ligjit nr 139/2015 "Për Vetëqeverisjen Vendore", ligjin 9936 datë 26.08.2008 "Për Menaxhimin e Sistemit Buxhetor në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar, kreu III nenet 10-20, kreu IV nenet 20-29, kreu VII nenet 39-40 të ligjit Nr 68/2017 "Për Financat e Qeverisjes Vendore" ligjin Nr 10296 datë 08.07.2010. "Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin".

Bashkëlidhur po ju vendosim relacionin mbi realizimi të treguesve ekonomik për katër mujin e parë të 2025

*Duke ju falenderuar për bashkëpunimin!*

**KRYETARI I BASHKISË**

**Vangjel TAVO**

Konceptoi: J. Kollagji

Pranoi: An. Konomi

Miratoi: L. Mezani





REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
BASHKIA HIMARË  
DREJTORIA E ZHVILLIMIT EKONOMIK

Nr. 3930 prot.

Himarë, më 26.05.2025

**Lënda:** Relacion mbi realizimin e treguesve ekonomik për katër mujorin e parë të 2025

#### **Hyrje**

- Baza ligjore dhe qëllimi i raportit

#### **Analiza e të Ardhurave**

- Plani dhe realizimi i të ardhurave për periudhën 9-mujore
- Analiza e devijimeve dhe faktorëve ndikues

#### **Analiza e Shpenzimeve**

- Plani dhe realizimi i shpenzimeve për periudhën 9-mujore
- Kategori kryesore të shpenzimeve dhe analiza e devijimeve

#### **Performanca Financiare e Përgjithshme**

- Krahasimi midis planit dhe realizimit të përgjithshëm
- Performanca e njësive kryesore

#### **Rekomandimet**

- Masat për përmirësimin e të ardhurave dhe shpenzimeve
- Veprimet e nevojshme për realizimin e planit vjetor

#### **Përfundimi**

- Përmbledhje e ecurisë së deritanishme dhe pritshmëritë për periudhën e mbetur

# Hyrje

## 1.1. Qëllimi i Raportit:

### Të nderuar këshilltarë

Administrata e Bashkisë Himarë ka ndjekur një planifikim realist për të ardhurat e vitit 2025, por në analizën e katërmujorit të parë evidentohen disa tregues pozitivë dhe disa zëra që kërkojnë përmirësim të mëtejshëm.

### 1. Të ardhurat e përgjithshme

Plani katërmujor ishte **1,051,070,706 lekë**, ndërsa realizimi faktik arriti në **2,031,130,551 lekë**, që përfaqëson **193.2%** të planit, për shkak të përfshirjes së të ardhurave të trashëguara nga 2024 dhe të transfertave të pakushtëzuara.

## 1.2. Baza Ligjore:

Hartimi i këtij raporti mbështetet në disa akte ligjore të rëndësishme, si më poshtë:

- **Ligji Nr. 139/2015, datë 17.12.2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore”**, i cili përcakton kompetencat dhe përgjegjësitë e bashkive për menaxhimin e të ardhurave dhe shpenzimeve. Ky ligj, në nenet 8, 9, 10, 24, 40 dhe 54, vendos bazat për buxhetimin dhe menaxhimin financiar të bashkive.
- **Ligji Nr. 9936, datë 26.08.2008 “Për Menaxhimin e Sistemit Buxhetor në Republikën e Shqipërisë”**, i ndryshuar, ku në kreun III (nenet 10-20) dhe kreun IV (nenet 20-29), përcaktohen procedurat për planifikimin dhe realizimin e buxhetit të bashkisë.
- **Ligji Nr. 68/2017 “Për Financat e Qeverisjes Vendore”**, i cili rregullon burimet e financimit të bashkive, si dhe standardet për menaxhimin e tyre. Nenet 39 dhe 40 të këtij ligji vendosin detyrime për bashkitë në lidhje me raportimin financiar dhe përgjegjësitë në menaxhimin e buxhetit.
- **Ligji Nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin”**, që përcakton sistemet e kontrollit financiar të brendshëm për të siguruar një menaxhim të përgjegjshëm të fondeve publike.

## 1.3. Objektivat Kryesore të Raportit:

- **Analiza e realizimit të të ardhurave:** Krahasimi i të ardhurave të planifikuara dhe të realizuara për periudhën 4-mujore, duke identifikuar zërat që kanë tejkaluar ose nuk kanë arritur pritshmëritë.
- **Analiza e shpenzimeve:** Vlerësimi i realizimit të shpenzimeve në lidhje me sektorët kryesorë dhe programet e bashkisë, duke theksuar kapitujt ku ka pasur devijime.

- **Vlerësimi i performancës financiare:** Krahasimi i performancës së përgjithshme financiare me objektivat fillestare dhe planifikimi për përmirësime në periudhën e mbetur të vitit.
- **Rekomandimet për periudhën e mbetur:** Propozime për masa konkrete për përmirësimin e mbledhjes së të ardhurave dhe menaxhimin më efektiv të shpenzimeve.

## Analiza e të Ardhurave

### 2.1. Plani dhe Realizimi i të Ardhurave për periudhën 9-mujore

Gjatë periudhës 4-mujore të vitit 2024, Bashkia Himarë ka parashikuar mbledhjen e të ardhurave në disa kategori kryesore: taksa, tarifa, dhe të ardhura nga asetet e Bashkisë Himarë. Realizimi i të ardhurave për këto kategori tregon një përputhje të përgjithshme me planifikimin, megjithatë disa devijime janë vërejtur.

Më poshtë është një tabelë përmbledhëse që tregon planin vjetor, planin për 4-mujorin dhe realizimin e të ardhurave gjatë kësaj periudhe:

Emertimi i te Ardhurave Tatimore	Plan	Plan 4 m	Fakt	Realizimi
<b>Te ardhura nga taksa</b>	<b>1,094,353,251</b>	<b>364,784,417</b>	<b>182,151,668</b>	<b>49.9%</b>
Tatim i thjeshtuar mbi Biznesin	2,000,000	666,667	105,630	15.8%
Taksa Vjetore e Mjeteve te Perdorura	4,500,000	1,500,000	2,542,695	169.5%
Taksa mbi kalimin e te drejtes se Pronesise	27,000,000	9,000,000	1,789,304	19.9%
Taksa mbi Renten Minerare	1,000,000	333,333	4,512	1.4%
Tatimi i te ardhurave personale	4,500,000	1,500,000	410,419	27.4%
Taksa e Nderteses	44,000,000	14,666,667	2,660,799	18.1%
Taksa e Truallit	6,000,000	2,000,000	670,156	33.5%
Taksa e Tokes Bujqesore	4,500,000	1,500,000	868,266	57.9%
Taksa e Ndikimit ne Infrastrukture	973,353,251	324,451,084	151,024,557	46.5%
Taksa e Fjetjes ne Hotel	22,000,000	7,333,333	1,823,700	24.9%
Taksa te Perkohshme	4,000,000	1,333,333	126,000	9.5%
tE TJERA	1,500,000	500,000	20,125,629	4025.1%
<b>Te ardhura nga tarifat</b>	<b>261,523,000</b>	<b>87,174,333</b>	<b>76,595,788</b>	<b>87.9%</b>
Tarife Pastrimi	90,000,000	30,000,000	13,863,185	46.2%
Tarife Gjelberimi	11,000,000	3,666,667	3,556,077	97.0%
Tarife Ndricimi	11,000,000	3,666,667	3,568,937	97.3%

Tarife Per Zenien e Hapsires Publike	100,000,000	33,333,333	47,733,815	143.2 %
Tarifa per Leje Ndertimi	20,000,000	6,666,667	2,214,248	33.2%
Tarife per Sherbime Komunale	5,000,000	1,666,667	1,188,142	71.3%
Tarifa per Sherbime Administrative	8,000,000	2,666,667	40,000	1.5%
Tarife KUZ	0	0	1,789,304	
Tarife Parkimi	8,023,000	2,674,333	92,000	3.4%
Tarife Leje Licenca	1,000,000	333,333	250,000	75.0%
Kamatevonesa	1,500,000	500,000	2,174,080	434.8 %
		0		
Gjoba	6,000,000	2,000,000	126,000	6.3%
<b>Te ardhura nga shitja e prones dhe dhenia me qera</b>	<b>10000000</b>	<b>3,333,333</b>	<b>0</b>	<b>0.0%</b>
Shitje te Pasurive te Paluajtshme		0		
Qira Ndertesa	1,000,000	333,333		0.0%
Qira Troje	4,000,000	1,333,333	0	0.0%
Qira Kullota	5,000,000	1,666,667		0.0%
<b>Te ardhurat gjithsej (I+II+III)</b>	<b>1,365,876,251</b>	<b>455,292,084</b>	<b>258,747,456</b>	<b>56.8%</b>
Te ardhura te trasheguara nga 2023	1,446,226,028.00	482,075,343	1,446,226,028	300.0 %
Te ardhura nga debitor te prapambetur	35,000,000.00	11,666,667	20,047,229	171.8 %
Te ardhura nga transferta e pakushtezuar e pergjithshme	205,509,549.00	68,503,183	205,509,549	300.0 %
Te ardhura nga granti I pakushtezuar sektorial	100,600,289.00	33,533,430	100,600,289	300.0 %
Granti specifik Mbrojtja Civile				
<b>Totali</b>	<b>3,153,212,117</b>	<b>1,051,070,706</b>	<b>2,031,130,551</b>	<b>193.2%</b>

Ashtu si përcaktohet në tabëlën përmbledhëse më sipër vërejmë që plani 4 mujor për seksionin e taksave është realizuar në masën 49.9% por nëse analizojmë zërat e taksave veçanërisht vërejmë një deviancë mbi taksat më hollësisht:

### **1. Tatimi i Thjeshtuar mbi Biznesin**

Çdo tatimpagues, i cili kryen një biznes, me anë të të cilit realizohet gjatë vitit fiskal qarkullim më i vogël ose i barabartë me 8 000 000 (tetë milionë) lekë, i nënshtrohet detyrimit të pagesës së tatimit të thjeshtuar mbi fitimin për biznesin e vogël. Kjo mospërputhje është kryesisht e lidhur me natyrën sezonale të aktiviteteve të biznesit në territorin e Bashkisë, ku shumica e subjekteve zhvillojnë aktivitet gjatë muajve të sezonit turistik. Përmirësimi i kësaj takse kërkon ndërhyrje në drejtim të njoftimit dhe sensibilizimit të tatimpaguesve për detyrimet e tyre, sidomos në muajt e sezonit nga DRT.

### **2. Taksa Vjetore e Mjeteve të përdorura**

Taksa vjetore e mjeteve të përdorura është një detyrim i pronarëve të mjeteve motorike, e cila llogaritet për një periudhë prej 365 ditësh sipas formulës që përfshin cilindratin e mjetit, koeficientin fiks sipas vjetërsisë, dhe llojin e karburantit. Në katërmujorin e parë të vitit 2025, kjo taksë ka realizuar **2,542,695 lekë** nga plani prej **1,500,000 lekë**, duke rezultuar në një realizim prej **169.5%**.

Ky realizim i lartë tregon për një përmirësim të mbledhjes së të ardhurave, por gjithashtu evidenton mundësinë që ky zë mund të ketë përfituar nga mbledhja e detyrimeve të prapambetura ose nga kontrolli teknik vjetor i detyruar nga DPSHTRR. Bashkia duhet të vijojë koordinimin me strukturat përgjegjëse për të siguruar një proces të vazhdueshëm dhe të kontrolluar të mbledhjes së kësaj takse.

### **3. Tatim mbi të Ardhurat Personale**

Tatimi mbi të ardhurat personale është një detyrim që i aplikohet të ardhurave të individëve rezidentë dhe jorezidentë në territorin e Bashkisë Himarë. Ky tatim përfshin të gjitha burimet e të ardhurave të realizuara në territorin e Republikës së Shqipërisë. Për katërmujorin e parë të vitit 2025, kjo taksë ka realizuar **410,419 lekë** nga plani prej **1,500,000 lekë**, duke përfaqësuar **27.4%** të planifikimit.

Ky realizim i ulët ka ardhur kryesisht për shkak të faktit që pagesat e kësaj takse janë të lidhura me deklaratimet e të ardhurave nga individët dhe subjektet, të cilat zakonisht bëhen në tremujorin pasardhës. Përmirësimi i mbledhjes së kësaj takse kërkon përforsimin e bashkëpunimit me institucionet tatimore dhe ndërgjegjësimin e qytetarëve për përmbushjen në kohë të detyrimeve fiskale.

### **4. Taksa mbi kalimin e te drejtes se pronesisë**

Agjenti i taksës dhe i tatimit mbi të drejtën e kalimit të pronësisë është zyra e regjistrimit të pasurive të paluajtshme, e cila kalon të ardhurat e mbledhura në favor të pushtetit vendor dhe

administratës tatimore brenda afateve të përcaktuara në ligj. Parashikimi mbi arkëtimin e kësaj takse kryhet mbi trendin rrites se transaksioneve por mosmenaxhimi i zonës ka bërë që të kemi një parashikim pesimist. Kjo taksë aplikohet për transaksionet e shitblerjes së pasurive të paluajtshme, ku agjenti tatimor është Zyra e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme. Në katërmujorin e parë të vitit 2025, realizimi ka qenë **1,789,304 lekë** nga plani prej **9,000,000 lekë**, duke përfaqësuar një realizim prej **19.9%**.

Ky realizim i ulët është ndikuar nga vonesat në regjistrimin e pasurive dhe një numër më i vogël transaksionesh se parashikimi. Përmirësimi i këtij zëri kërkon një koordinim më të mirë me Agjencinë Shtetërore të Kadastrës dhe ndërmarrjen e masave për nxitjen e regjistrimeve të pronësisë, sidomos për transaksionet e reja.

## **5. Renta Minerare**

Renta Minerare është një detyrim që i aplikohet çdo personi fizik ose juridik që është i licencuar për të ushtruar veprimtari në industrinë minerare, mbi dhe nën tokë, në territorin e Bashkisë Himarë. Për katërmujorin e parë të vitit 2025, janë realizuar vetëm **4,512 lekë** nga plani prej **333,333 lekë**, që përbën **1.4%** të realizimit të planifikuar.

Kjo përqindje e ulët tregon se nuk janë kryer rakordime të plota nga strukturat përgjegjëse ose nuk janë realizuar pagesat nga subjektet që operojnë në sektorin minerar. Rekomandohet që Bashkia të intensifikojë bashkëpunimin me ministrinë përgjegjëse dhe subjektet minerare për të përmirësuar zbatimin dhe arkëtimin e kësaj takse në periudhat në vijim.

## **6. Taksa e Pasurisë**

Taksa e Pasurisë përfshin të tre komponentët: taksën e ndërtesës, taksën e truallit dhe taksën e tokës bujqësore. Në katërmujorin e parë të vitit 2025, këto zëra kanë shënuar:

- **Taksa e Ndërtesës:** realizim **2,660,799 lekë** nga plani prej **14,666,667 lekë** (realizim **18.1%**)
- **Taksa e Truallit:** realizim **670,156 lekë** nga plani prej **2,000,000 lekë** (realizim **33.5%**)
- **Taksa e Tokës Bujqësore:** realizim **868,266 lekë** nga plani prej **1,500,000 lekë** (realizim **57.9%**)

Ky nivel realizimi është ndikuar nga sezonaliteti i aktivitetit ekonomik dhe nga fakti që shumë subjekte nuk kanë kryer pagesat për periudhën e parë të vitit. Përmirësimi i mbledhjes së këtyre taksave kërkon forcimin e bashkëpunimit me agjentët tatimorë dhe nxitjen e pagesave nga subjektet, veçanërisht me fillimin e sezonit turistik.

## **7. Taksa e Fjetjes në Hotel**

Kjo taksë aplikohet për subjektet që ushtrojnë aktivitet në fushën e hotelerisë dhe akomodimit në territorin e Bashkisë Himarë. Për katërmujorin e parë të vitit 2025, janë arkëtuar **1,823,700 lekë** nga plani prej **7,333,333 lekë**, duke përfaqësuar një realizim prej **24.9%**.

Ky realizim i ulët është i lidhur me natyrën sezonale të aktivitetit turistik në Himarë, ku pjesa më e madhe e hoteleve fillojnë të funksionojnë në kapacitet të plotë vetëm në tremujorin e dytë dhe të tretë të vitit. Përmirësimi i këtij treguesi kërkon monitorim të vazhdueshëm të deklarimeve nga subjektet hoteliere dhe intensifikim të mbledhjes së detyrimeve përkatëse.

#### 8. Taksa e Ndikimit në Infrastrukturë

Kjo taksë është e lidhur ngushtë me aktivitetet ndërtimore dhe zhvillimet e pasurive të paluajtshme në territorin e Bashkisë Himarë, ku ajo aplikohet si një detyrim financiar nga subjektet që kryejnë ndërtim. Për katërmujorin e parë të vitit 2025, janë arkëtuar **151,024,557 lekë** nga plani prej **324,451,084 lekë**, duke rezultuar në një realizim prej **46.5%**.

Ky nivel realizimi është ndikuar nga ritmi sezonal i zhvillimeve ndërtimore dhe nga proceset e regjistrimit të pasurive pranë Agjencisë Shtetërore të Kadastrës. Përmirësimi i kësaj takse kërkon rritjen e kontrollit dhe monitorimit të aktiviteteve ndërtimore në territorin e Bashkisë, si dhe nxitjen e legalizimeve dhe regjistrimeve përkatëse. Kjo taksë mbetet një ndër burimet kryesore të të ardhurave të Bashkisë, sidomos në periudhat e mëvonshme të vitit.

#### Plan 4 mujor me Fakt




Fig.1 Grafiku krahasues plan fakt 4 mujor mbi taksat vendore

Të ardhurat nga tarifat përbëjnë një zë të rëndësishëm në buxhetin e Bashkisë Himarë, të lidhura kryesisht me ofrimin e shërbimeve publike dhe menaxhimin e hapësirave. Për katërmujorin e parë të vitit 2025, janë arkëtuar **76,595,788 lekë** nga plani prej **87,174,333 lekë**, duke rezultuar në një realizim prej **87.9%**.

Ndër zërat kryesorë të tarifave, **Tarifa për Zënien e Hapësirës Publike** ka shënuar një realizim të lartë prej **143.2%**, duke reflektuar një menaxhim efektiv të hapësirave publike. Nga ana tjetër, **Tarifa për Pastrim**, **Tarifa për Shërbime Komunale** dhe **Tarifa për Shërbime Administrative** kanë realizuar përkatësisht **46.2%**, **71.3%** dhe **1.5%** të planit, duke sinjalizuar nevojën për përmirësim në mbledhjen dhe menaxhimin e këtyre shërbimeve. Rekomandohet forcimi i kontrolleve dhe përmirësimi i shërbimeve për të rritur më tej të ardhurat nga tarifat vendore.

## Plan 4 m e Fakt




Fig.2 Grafiku krahasues plan fakt 4 mujor mbi tarifat vendore

### Tarifa e Pastrimit

Kjo tarifë aplikohet për ofrimin e shërbimeve të pastrimit të hapësirave publike dhe mbledhjen e mbetjeve urbane. Për katërmujorin e parë të vitit 2025, janë arkëtuar **13,863,185 lekë** nga plani prej **30,000,000 lekë**, duke përfaqësuar një realizim prej **46.2%**. Ky nivel tregon nevojën për përmirësimin e sistemit të mbledhjes së detyrimeve dhe rritjen e ndërgjegjësimit të qytetarëve për detyrimin e pagesës së kësaj tarife.

## Tarifa e Gjellbërimit

Kjo tarifë aplikohet për shërbimet e mirëmbajtjes së sipërfaqeve të gjelbra dhe hapësirave publike të gjellëruara. Në katërmujorin e parë të vitit 2025, janë arkëtuar **3,556,077 lekë** nga plani prej **3,666,667 lekë**, duke arritur një realizim prej **97.0%**. Ky rezultat pozitiv tregon një menaxhim të mirë të detyrimeve për këtë tarifë.

## Tarifa e Ndriçimit

Tarifa e Ndriçimit mbulon kostot për ofrimin e shërbimeve të ndriçimit publik. Për këtë periudhë, janë realizuar **3,568,937 lekë** nga plani prej **3,666,667 lekë**, që përbën **97.3%** të planifikimit. Ky realizim i lartë është tregues i një procesi efektiv të menaxhimit të tarifës dhe të arkëtimit të saj.

## Analiza e Shpenzimeve

### Shpenzimet e Buxhetit Vendor

Për katërmujorin e parë të vitit 2025, **shpenzimet gjithsej të buxhetit vendor** janë realizuar në masën **138,222,783 lekë**, nga plani vjetor prej **3,823,956,985 lekë**. Ky realizim paraqet një nivel të ulët të shpenzimeve në raport me planin, i ndikuar nga sezonaliteti i aktiviteteve dhe ritmi i zbatimit të projekteve.

- **Shpenzimet korrente** janë realizuar në **136,992,572 lekë** nga plani vjetor prej **1,021,637,068 lekë**, me shpërndarje si më poshtë:
  - **Paga dhe fond i veçantë për paga: 69,081,319 lekë**, që përfaqëson një përqindje të konsiderueshme të shpenzimeve korrente, në përputhje me detyrimet ligjore dhe strukturën e stafit.
  - **Kontributi për sigurime shoqërore: 11,468,115 lekë**, i lidhur me detyrimet për sigurimet e punonjësve.
  - **Shpenzimet operative: 40,168,282 lekë**, që përfshijnë shpenzimet për funksionimin e institucioneve, furnizimet dhe shërbimet.
  - **Të tjera korrente: 16,274,856 lekë**, ku përfshihen shpenzime për aktivitete të ndryshme dhe mbështetje të shërbimeve.
- **Shpenzimet kapitale** janë realizuar në një nivel shumë të ulët, vetëm **1,230,211 lekë** nga plani vjetor prej **2,802,319,917 lekë**. Kjo tregon se në katërmujorin e parë, nisja e

investimeve dhe projekteve kapitale ka qenë e kufizuar, me pritshmëri për përshpejtim të ritmit të zbatimit në periudhat në vijim.

Ky nivel i ulët i shpenzimeve kapitale është karakteristik për këtë periudhë, ku procedurat e prokurimit dhe përgatitja e projekteve shpesh shënojnë një nisje të ngadaltë. Për këtë arsye, është e nevojshme që në periudhën e ardhshme të rritet përqendrimi në përfundimin e procedurave të planifikuara dhe zbatimin e projekteve, në mënyrë që buxheti të realizohet sipas parashikimeve.

			<b>Plani</b>	<b>Fakt</b>	<b>Realizim %</b>
1	600	600 Shpenzime për pagat	274,690,979	69,081,319	25.1%
2	601	601 Sig. shoqërore dhe shëndetësore	63,744,659	11,468,115	18.0%
3	602	602 Shpenzime operative	552,063,851	40,168,282	7.3%
4	603	603 Subvencione	3,000,000	0	0.0%
5	604	604 K.Qarkut+ emergj.civile + transferta	21,486,886	0	0.0%
6	606		34,655,000	16,274,856	47.0%
7	609	609 Fondi rezervë dhe kontigjenca, emergjence civile	61,995,693	0	
8	231	231 Investime objekte	1,924,276,971	0	0.0%
9	230	230 Studime projektive	117,800,000	1,230,211	1.0%
		<b>TOTALI</b>	<b>3,053,714,039</b>	138,222,783	4.5%

Në analizën e realizimit të shpenzimeve për periudhën 4-mujore të vitit 2025, janë vërejtur disa devijime nga plani fillestar. Këto devijime kanë ndikuar në mospërbushjen e objektivave financiare për këtë periudhë. Disa nga faktorët kryesorë që kanë çuar në mosrealizimin e plotë të shpenzimeve përfshijnë:

Një faktor tjetër i rëndësishëm që ka ndikuar në mosrealizimin e shpenzimeve ka qenë periudha zgjedhore. Gjatë periudhës së zgjedhjeve, prokurimet publike pezullohen për të shmangur ndikimet politike në shpenzimet publike dhe për të garantuar që fondet të mos

përdoren për qëllime elektorale. Ky pezullim i aktiviteteve të prokurimit përfshin investimet në projekte infrastrukturore dhe shpenzimet për shërbime të tjera publike.

Periudha zgjedhore, e cila përkoi me muaji 4 të vitit, ka shkaktuar vonesa në nisjen e projekteve të reja dhe ka ndikuar në realizimin e buxhetit për periudhën 4-mujore. Në shumë raste, kontratat dhe procedurat e tenderimit janë shtyrë për t'u përfunduar pas përfundimit të zgjedhjeve, çka ka sjellë devijime në shpenzimet e planifikuara.

Në përfundim, Bashkia Himarë mbetet e përkushtuar për të siguruar që të gjitha projektet prioritare të parashikuara për vitin 2025 të nisin brenda këtij viti, ndërsa do të vijojë të monitorojë dhe të planifikojë investimet për periudhën e ardhshme, duke garantuar që projektet e nisura në vitin 2024 të përfundojnë brenda kornizës financiare të planifikuar për vitin 2025.

***Duke ju falenderuar për bashkëpunimin!***

**KRYETARI I BASHKISË**

**Vangjel TAVO**



Konceptoi: J. Kollagji

Pranoi: An. Konomi

Miratoi: L. Mezani